



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT

Drejtoria	Drejtoria e Shëndetësisë
Periudha Raportuese	Tetor, 2020
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Dr. Bujar Gashi, drejtor i DSH-së
Përgatitur	Dr. Fatlinda Hoxha, zyrtare për shëndetësi në DSH

1. PËRMBLEDHJE

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues

Gjatë muajit tetor 2020, Drejtoria e Shëndetësisë pranoi 86 lëndë të ndryshme për t'u shqyrtuar nga stafi i saj, si dhe nga komisioni profesional. Stafi në këtë drejtori kishte takime të përditshme me qytetarë, për t'u njoftuar me procedura dhe shërbime sipas interesit dhe kërkesave të tyre.

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

Listoni aktivitetet për muajin raportues, të parapara sipas planprogramit të Komunës për drejtorinë tuaj:

- Renovime dhe përmirësimeve të infrastrukturës në objekte shëndetësore;
- Monitorim dhe mbështetje të aktiviteteve bazuar në kontratat aktive;
- Monitorimi i mbarëvajtjes së punës në përditshmëri të personelit shëndetësor në QKMF dhe njësitë e saj, si dhe në QMU;

- Identifikimi i nevojave për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore në kuadër të KPSH-së;
- Inicimi i përgatitjeve administrative zbatimi i plan të prokurimit 2020;
- Përpilimi i raporteve të ndryshme në kuadër të Drejtorisë.

3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë:

- Identifikimi i nevojave rreth përpilimit të specifikave:
 - Furnizim me barna dhe material shpenzues për QKMF dhe QMU;
 - Furnizim me inventar për nevojat e objekteve shëndetësore - KPSH;
- Monitorim i aktiviteve:
 - Renovimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së objektit QMU-së;
 - Furnizim me barna dhe material shëndetësor mjekësor;
- Furnizim me material administrativ shëndetësor;
- Përcaktim i stafit menaxhues për aktivitetin:
 - Pastrimi i objekteve shëndetësore QKMF-së dhe QMU-së;
 - Furnizim me teste serologjike;
- Monitorimi i mbarëvajtjes së përditshmërisë të personelit shëndetësor në QKMF dhe njësitë e saj, si dhe në QMU;
- Takime të vazhdueshme me menaxhmentin QKMF dhe QMU në lidhje me përditshmërinë e punës me qytetarë;
 - Në prioritet ndërmarrjen e masave preventivë rreth parandalimit të koronavirusit;
 - Njoftim i vazhdueshëm rreth riorganizimit të personelit shëndetësor mbi gatishmërinë e përhapjes së koronavirusit;
- Gjatë muajit tetor, 1972 qytetarë rezultuan pozitiv me COVID - 19; përderisa të shëruar ishin 1390 qytetarë;



- Laboratori "Eramed" dhuroi donacion për laboratorin në QKMF të Prishtinës prej 4 aparateve për testime hematologjike;

- Përpilim i të dhënave - Plani i veprimit për përmirësimin e performancës për vitin 2021 - Komuna e Prishtinës - MSH;



Përfundim i renovimit të objektit të QMU-së, si dhe inventarizim për të rifilluar ofrimin e shërbimeve shëndetësore; Në QMU u rinovuan dhe inventarizuan tërësisht të gjitha hapësirat e objektit, hapësirat e parkimit, oborrit me hapësirat e gjelbërimit rreth

objektit.

- Drejtorja e Shëndetësisë dhe Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) fillojnë fushatën “Zbulimi i hershëm - mbijetesë”. Përgjatë muajit tetor, në njësinë e Radiologjisë në QKMF, shërbimet e mamografisë u ofruan pa pagesë për të gjitha gratë e territorit të komunës së Prishtinës;
- Zhvillohet procesi i deratizimit vjeshtor (eliminimit të brejtësve) i rrjetit të kanalizimit, bodrumeve dhe garazheve publike nëpër lagjet e Prishtinës;
- Fillim i procedurës së rekrutimit të zyrtarëve publikë, bazuar në konkursin publik.

4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtorja juaj për muajin raportues:

- Identifikimi i nevojave për ofrimin e shërbimeve shëndetësore cilësore edhe gjatë gjendjes emergjente si pasojë e pandemisë globale;
- Identifikimi i nevojave për lehtësimin e punës së përditshme të personelit shëndetësorë edhe gjatë gjendjes emergjente si pasojë e pandemisë globale;
- Përgatitje teknike rreth vlerësimit të lëndëve për subvencione në fushën e shëndetësisë.

5. STATISTIKAT

Të listohen të gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika të tjera specifike që mund të ketë drejtorja juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës.

5.1.1. Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese:

Fondi burimor	Planifikuara	Alokuara	Shpenzuara	Nr. lëndëve
Pagat	7,140,000	6,009,252.76	498,834.77	
Mallra dhe shërbime	1,360,000			
10	1,010,000.00		37,153.48	32
21	400,000.00	200,000.00		
4	867,637.00		208,657.95	48
Komunali	310,000.00	284,166.67		
Subvencione	1,200,000.00			
Kapitale	1,190,000.00			
21		890,000.00	49,094.50	5
22		599,738.46	43,515.29	1
Gjithsej			837,255.99	86

Aktivitet gjatë muajit tetor, 2020

Raport - deklarin të borxheve më të vjetra se 30 ditë;

Deklarimi për

ATK;

Raport javor dhe mujor, shpenzimet e realizuara për të hyrat nga bashkëpagesat për shërbime shëndetësore;

Pranim të faturave dhe arkivimi i tyre;

Përgatitja e dokumenteve të nevojshme për procedim të mëtutjeshëm;

Zotimi ;

Dërgimi i lëndëve për procedim të mëtutjeshëm në Prokurim dhe Financa;

Përgatitja e deklaratave të disponueshmërisë për procedura të prokurimit.

5.1.2. Takimet me palë

5.1.3. Takimet me institucione të tjera:

- Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit;
- Drejtoria e Kadastrit;
- Drejtoria e Investimeve Kapitale
- Drejtoria e Prokurimit;
- Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit;
- Zyra e regjenerimit urban.

5.1.4. Diskutime publike/takimet me qytetarë.

Raportime të përditshme me media lokale: RTV 21, RTV Dukagjini, TV Klan dhe RTK;

5.1.5. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare

- Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, rreth renovimit të QMF 4;
- Drejtoria e Kadastrit, rreth renovimit të QMF 4;

5.1.6. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër.

5.1.7. Përfitues të subvencioneve.

Më 15 tetor 2020, në takimin e Komisioni profesional u miratuan 185 lëndë.

5.1.8. Takime të tjera

- MSH,
- IKSHIP,
- QKMF,
- QMU;
- Ambasada amerikane në Kosovë, ofrim cilësor dhe sasior i shërbimeve shëndetësore në KPSH në kohë pandemie.

6. SFIDAT

Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda Drejtorisë, Komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutem shpjegoni në këtë hapësirë.

- Mungesa e stafit në DSH;
- Mungesa e shefit të DSH-së tani e sa vite;
- Mungesa e stafit shëndetësor në objektet e KPSH-së;
- Trajnime të ndryshme të personelit, DSH, përgjegjësitë e përditshme zyrtare;
- Numri jo mjaftueshëm i stafit shëndetësor, bazuar në nevoja të qytetarëve;

- Buxhet jo i mjaftueshëm, sidomos për kategorinë “Mallra dhe shërbime”, ku me rritjen e numrit të pacientëve dhe shërbimeve, rrezikojmë shërbimet e vazhdueshme deri në fund të vitit.

7. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR PERIUDHEN PASUESE

- Përgatitjet për publikimet e tenderëve bazuar në planin e prokurimit;
- Monitorim i përditshmërisë së personelit për të ndikuar në shërbime shëndetësore cilësore dhe të qasshme;
- Pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme profesionale.

8. TË TJERA

Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme

QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE

RRJEDHA E PUNËS

- Gjatë muajit tetor 2020, vazhdoi organizimi i brendshëm i përshtatur me situatën epidemiologjike, për ofrimin e shërbimeve shëndetësore. Në tri Qendra të Mjekësisë Familjare (QKMF, QMF IV dhe QMF V), ka vazhduar puna pa ndërprerje (24/7) në ndërresat e zakonshme (07:13:30; 13:30 – 19:00 dhe 19:00 – 07:00). Katër qendrave të tjera (QMF 2, QMF 6, QMF Besi dhe QMF Hajvali) gjatë tetorit iu janë shtuar edhe tri qendra (QMF 10, QMF 11 dhe QMF Mat 1) me orarin e punës prej: 07:00 – 19:00, po ashtu në ndërresë të zakonshme si më lart. Në qendrat tjera (QMF 1, 3, 8, 9, është punuar në një ndërresë nga ora 08:00 – 16:00.
- Ky organizim i punës është bërë për të përballuar nevojat dhe kërkesat për zbatimin e masave, rekomandimeve dhe obligimeve tona kundruall parandalimit dhe frenimit të pandemisë COVID-19, përkundër mungesës së numrit të mjaftueshëm të personelit. Numri i stafit të infektuar deri më 31 tetor 2020, ka arritur shifrën prej 198 personave;
- Në të gjitha Qendrat e Mjekësisë Familjare, në hyrje kanë vazhduar të qëndrojnë ekipet e përbëra nga (mjeku familjar dhe infermiera) për triazhimin e pacientëve;
- QMF 7 – Emshir, ka vazhduar të shërbejë si qendër për administrimin e terapisë parenterale për qytetarët e Prishtinës të infektuar me COVID 19 edhe gjatë muajit tetor në dy ndërresa 8-orëshe: 8:00 – 16:00 dhe 16:00 – 24:00. Gjatë muajit tetor janë administruar plot 1398 infuzione (775 në ndërresën e parë dhe 756 gjatë ndërresës së dytë) me një mesatare prej rreth 45 infuzionesh brenda 16 orëve dhe me varirime prej 8 (më 11 tetor) deri më 133 (31 tetor 2020), dhe me një trend të rritjes rapide. Prandaj, që nga 30 tetori është rritur kapaciteti i QMF 7 edhe për tre shtretër dhe është përforcuar stafi me një infermiere shtesë;

- Gjatë vizitave monitoruese në të gjitha Qendrat e Mjekësisë Familjare (ndërresa e paradites, pasdites dhe ndërresa e natës) nuk janë konstatuar mangësi serioze;
- Poliklinika e Stomatologjisë dhe shërbimi stomatologjik vazhdojnë punën në të gjitha QMF-të me orar të rregullt dhe ka kthyer të gjitha shërbimet e veta në funksion;
- Përgatitje teknike rreth imunizimit ndaj gripit sezonal, ku qytetarët do të njoftohen me kohë.

Gjatë muajit tetor 2020 janë realizuar gjithsej:

- ✓ 73441 vizita mjekësore;
- ✓ 91951 shërbime shëndetësore;
- ✓ 70592 shërbime laboratorike;
- ✓ 13035 shërbime stomatologjike;
- ✓ 2394 shërbime radiologjike.

REKOMANDIME

- Planifikimin e nevojave për PPM dhe pajisjes tjera medicinale për përballimin e valës së dytë të pandemisë me COVID-19 në vjeshtë.

QENDRA E MJEKËSISË URGJENTE

Qendra e Mjekësisë Urgjente në Prishtinë gjatë muajit shtator, vazhdoi organizimin e brendshëm, përshtatur me situatën epidemiologjike, për ofrimin e shërbimeve shëndetësore urgjente.

Gjatë muajit shtator, QMU ka mbështetur këto aktivitete:

- Më 03.09.2020, me kërkesën e Federatës së Futbollit të Kosovës, në stadiumin e qytetit "Fadil Vokrri" asistoi në 2 seanca stërvitore të ekipeve U 21 të Kombëtares së Kosovës dhe Anglisë;
- Më 04.09.2020, asistoi në ndeshjen zyrtare, të vlefshme për kualifikim në kampionatin evropian, në mes Reprerentacionit U21 të Kosovës dhe Anglisë;
- Më 16.09.2020, asistoi me një ekip mjekësor në stadiumin "Fadil Vokrri", në stërvitjet e Reprerentacionit të Kosovës dhe Estonisë;
- Më 17.09.2020, asistoi në ndeshjen zyrtare të FIFA-së mes Reprerentacionit të femrave Kosovë - Lituani.

Nga raportimet e stafit mjekësor, rastet urgjente janë trajtuar sipas prioriteteve të triazhës, dominuan rastet me:

- Hipertension arterial;
- Bronchiti acut;
- Sëmudjet kronike obstructive të mushkërive;
- Astma bronchiale;
- Colikat abdominale;
- Reakcionet e stresit psikotraumatik;
- Gastroenterocolite acut;

- Reumatoid artrhiti;
- Aksidentet e trafikut etj.

QMU kishte mesatarisht rreth 200 thirrje gjatë 24 h në linjën emergjente 194 nga ana e qytetarëve. Furnizimi me mjete mbrojtëse (veshje, maska, doreza, kalaqe, syze) kundër COVID -19, ishte në nivelin e duhur.

QMU gjatë kohës së pandemisë COVID -19 me përkushtimin e të gjithë stafit mjekësor dhe mbështetës, me sukses vazhdon të kryej detyrat dhe misionin e vet, duke iu ofruar ndihmë mjekësore urgjente të gjithë qytetarëve.

Mbështetja e aktiviteteve sportive

Më 08.10.2020, me kërkesën e Federatës së Futbollit të Kosovës, në stadiumin “Fadil Vokrri” u asistua në 2 seanca stërvitore të ekipeve U 21 të Kombëtares së Kosovës dhe Austrisë;

Më 09.10.2020, në stadiumin “Fadil Vokrri”, u sigurua ndeshja zyrtare e vlefshme për kualifikim në kampionatin Evropian, mes Reprerentacionit U21 të Kosovës dhe Austrisë;

Më 10.10.2020, është asistuar në treningun e Reprerentacionit të Kosovës dhe Sllovenisë;

Më 24 dhe 25.10.2020, një ekip mjekësor mbështeti turnirin në fshatin Mazgit. Ky aktivitet u mbajt me organizim nga Federata e Futbollit e Kosovës;

Më 26.10.2020, u asistua me një ekip mjekësor në stadiumin “Fadil Vokrri”, në stërvitjet e Reprerentacionit të femrave të Kosovës dhe Holandës;

Më 27.10.2020, është asistuar në ndeshjen zyrtare të FIFA-së mes Reprerentacionit të femrave Kosovë-Holandë;

1	Viz. mj. urgj. në terren	1057
	Viz. të tjera mjekësore	72
2	Vizita mjekësore në QMU	7
3	Shërbimi i kirurgjisë së vogël	0
4	Shërbimi i rea. n terren	0
	Shërbimi i rea. ne QMU	0
5	Observim (intenziv)	4
6	Shërbimi i infermierisë	8
7	Aksidentet	92
8	Fatkeqësitë në punë	5
	Fatkeqësitë të tjera	44
9	Shërbimi laboratorik	2
10	EKG	27
11	Transportet	165
12	Konstatim vdekjeje	46

GJITHSEJ

1529

